

## 6.8 FSHIRJA E FUSHËS 996 QË ËSHTË KRIJUAR NË MODULIN E PROGRAMIT COBISS3/PASURIMI

Nëse pas përfundimit të procedurës së pasurimit në modulën e programit COBISS3/Pasurimi konstatohet se fusha 996 është e tepërt, sepse njësi nuk do të vendoset në raft, këtë fushë mund ta fshini nga baza e të dhënave.

Fushën 996 mund ta fshijnë përdoruesit, të cilët për punë në modulën COBISS3/Pasurimi kanë privilegjin PAS\_THEM – kryerja e të gjitha procedurave në modul, përveç regjistrimit të të dhënave për fondet.

### ***Kushti***

Fusha është krijuar në procedurën e pasurimit në modulën e programit COBISS3/Pasurimi. Në fushën 996 nuk ka numër të inventarit.

### ***Procedura***

1. Në klasën **Fusha 996/997** ose në lidhshmëritë e klasës **Materiali** kërkoni dhe përzgjidhni fushën 996/997.
2. Përzgjidhni metodën **Objekti / Fshi fushën 996 të krijuar në procedurën e pasurimit**.

Fusha do të fshihet nga baza lokale e të dhënave në mjedisin COBISS2 dhe në mjedisin e COBISS3. Te materiali, në listën e ngjarjeve theksohet një ngjarje e re, me ç'rast futet ID e fushës që e keni fshirë.